

Dalës-lzazna

Nr. X-43
Br.

Data 22.01.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit - Opština Obilic - Municipality Obiliq

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, te Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative të MASHT-it, nr.15/2019, nr.17/2009, dhe nr.07/2017, rregullimi i procedurave në sektorin publik dhe kërkesën me nr. -X- 41, të datës 20.01.2020, Drejtoria e Arsimit me datë 22.01.2020, rishpall dhe shpall :

KONKURS

(Për plotësimin e vendeve të punës)

I.Gjimnazi “17 Shkurti” në Obiliq (rishpallje)

Vendi i punës: Drejtor shkolle

Vendi i punës: mësimdhënës i biologjisë, zëvendësim i pushimit të lehonisë

II. SHFMU” Pandeli Sotiri “ në Obiliq

Vendi i punës: Mësues klase , zëvendësim i pushimit të lehonisë me kohë të caktuar

Kushtet dhe kriteret për drejtor :

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e punës për drejtor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës ;
2. Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit sipas UA,15/2019, nenit 4, paragrafi 1.2;
3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit të MASHT për licencim të mësimdhënësve ose të jenë në procedurë të licencimit;
4. Të kenë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT, sipas rekomandimit të KSHLM;
5. Të kenë 5 vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për arsimin e mesëm të lartë;

6. Të posedojnë këto dokumente:

- 6.1 Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të profilit arsimor , në bazë të notmativiv profesional për arsim të përgjithshëm;
- 6.2 Certifikatën shëndetsore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetsor me të cilën dëshmohet gjendja e tij, e saj shëndetësore;
- 6.3 Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i, e dënuar për krim , dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- 6.4 Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- 6.5 Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilën ka konkurruar. Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst(një faqe për një fushë) me hapsirë 1.5, fonti i shkronjave 12, arial). Koncepti dorëzohet si pjesë e portfolios, por është edhe pjesë përbërëse e intervistës;

6.6 Letër referencë me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i institucionit edukativo-arimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim);

6.7 Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;

6.8 Portfolion profesionale (shih shtojca "G");

6.9 Kandidati, kandidatja për drejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit (deklaratë nën betim me shkrim e konkurruesit)

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës janë të parapara të Ligji nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të noterizuara, përveç pikës 6.9

Kohëzgjatja: Marrëdhënia e punës krijohet përmes kontratës në pajtim me Ligjin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Kushtet për mesimdhënës :

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ (MASHT), nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional Të Arsimit Të Përgjithshëm.

Kandidatët që konkurojnë për mesimdhënës duhet ta sjellin kopjen e diplomës së fakultetit të vërtetuar apo noterizuar, vërtetimin për përvojën e punës, certifikatën e lindjes, dokumentin e letërnjoftimit.

Kandidatët, që konkurrojnë për këto vendet e punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuara në MASHT nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Për të gjitha vendet e punës fletëkërkesat merren në Zyrën e Pranimit të KK-së, apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë. Kandidatët do të ftohen në intervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp dhe të faqja zyrtare e komunës.

Drejtori : Agim Spahiu

